




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 01.03.2017

Ref.: 123117

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 48-të, të mbajtur më 23 shkurt 2017, mori:

V E N D I M

I. REFUZOHET kërkesa për rishqyrtim të vendimit nr.763/16 e datës 06.12.2016 e Kolegjit "Dardania", si e pa bazuar.

II. Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së nr.1249/16, datë 07.11.2016.

Arsyetime

BPrAL Kolegji "Dardania" ka parashtruar kërkesë (nr. 763/16 e datës 06.12.2016) për rishqyrtim të vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (nr.1249/16, datë 07.11.2016). Përmes kësaj kërkesë, Kolegji Dardania ka kërkuar të rishqyrtohet vendimi për mos riakreditim të profileve/specializimeve në: Administrim Publik; Studime Evropiane dhe; Diplomaci, specializime këto në kuadër të programit të studimit Shkenca Politike dhe Administratë Publike, BA (180 ECTS), nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC).

KSHC ka shqyrtuar kërkesën e Kolegjit "Dardania" dhe ka vendosur të refuzojë kërkesën për rishqyrtim të datës 06.12.2016 dhe të lë në fuqi vendimin e KSHC-së të datës 07.11.2016.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) ka analizuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të dorëzuar nga Kolegji "Dardania" në lidhje me mos riakreditimin e specializimeve në kuadër të programit të studimit Shkenca Politike dhe Administratë Publike (Administrim Publik; Studime Evropiane dhe; Diplomaci). KSHC ka konstatuar se ky institucion nuk ka sjellë ndonjë dëshmi e cila do të mund të merrej parasysh për të ndryshuar vendimin e KSHC-së. KSHC konsideron se gjendja faktike në kohën e vlerësimit të Kolegjit Dardania është trajtuar me saktësi nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit dhe se argumentet për mos akreditimin e specializimeve të këtij programi të studimit janë ofruar në Raportin Final të Ekspertëve të pranuar më datë 25 Tetor 2016.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) ka analizuar edhe kërkesën për rishqyrtim të vendimit të dorëzuar nga Kolegji "Dardania" në lidhje me mos ri/akreditimin e specializimit Marrëdhënie me Publikun në kuadër të programit të studimit Shkenca Politike dhe Administratë Publike. KSHC ka konsideruar se arsyetimi i Kolegjit

1/2

Dardania se ky specializim ka akreditim deri në vitin 2017 nuk qëndron pasi që specializimi i programit të studimit nuk mund të ketë më tepër akreditim se sa programi bazë. Për më tepër sipas Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e IAL-ve në Kosovë Nr.20/2016, datë 20.09.2016, neni 5, përcaktohet se akreditimi mund të bëhet në nivelin e Institucionit; programit të studimit dhe të dyjave së bashku. Për informatën tuaj, institucioni juaj ka aplikuar edhe me këtë specializim për programin e studimit në Shkenca Politike dhe Administratë Publike pasi ky specializim është pjesë përbërëse e faqes së parë të raportit të vet vlerësimit për këtë program studimi, ky specializim është pjesë përbërëse e plan programit të paraqitur në raportin e vet vlerësimit (specializimi në semestrin e pestë), ky specializim është pjesë përbërëse e plan programit të paraqitur në raportin e vet vlerësimit në formën tabelare (specializimi në semestrin e pestë), ky specializim është vlerësuar nga eksperti ndërkombëtarë i akreditimit dhe në mënyrë të qartë eksperti i referohet vlerësimit të këtij specializimi si pjesë përbërëse e programit të studimit në tërësi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afatit për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit "Dardania";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Prishtinë, 30.11.2016

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA E AKREDITIMIT E KOSOVËS AGENCIJA ZA AKREDITOVANJE KOSOVA KOSOVO ACCREDITATION AGENCY	
Nr. Prot. Broj Prot. Doc. No.	763/16 Data: Datum: Date: 06.12.2016 Prishtinë / a

KËRKESË PËR RISHQYRTIM TË VENDIMIT

- ANKUES:** Kolegji Dardania, i themeluar në vitin 2004 si Institucion i Arsimit të Lartë, i licencuar nga MASHT – Certifikata Nr. 898/02-1 të datës 01.12.2004, dhe Vendimi Nr. 583/02-1 të datës 09.05.2007 dhe i riakredituar në nivel institucional prej pesë (5) viteve (01.tetor 2013 – 30 shtator 2018. Për këtë shih edhe Vendimet e AKA Nr. 493/13, datë 08.07.2013 dhe 551/14, datë 04.07.2014).
- OBJEKTI:** Kërkohet ndryshimi i vendimit Nr. 1249/16, datë 07.11.2016 të KSHC të AKA me objekt “Refuzimi i riakreditimit të specializimit Marrëdhënie me Publikun të programit Bachelor Shkenca Politike me Administrim Publik, të Kolegjit Dardania dhe miratimi i kërkesës për akreditim sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.
- BAZA LIGJORE:** Nenet 1, 2, 3, 4, 8, 11, 12, 13, 14 dhe 15 të Ligjit Nr. 04/L-037 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës”.
- Nenet 9, 10, 11, dhe 29 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së RSK Nr. 02/2013 “Mbi Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të, Lartë në Republikën e Kosovës”.
- Nenet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 11, 12, 13, 14, 44, 46-48, 52, 53, 55, 88, 89, 92, 95, 124, 125, 126, 127, 128, 129, 130, dhe 131 të Ligjit Nr. 05/L-031 “Për Procedurën e Përgjithshme Administrative”.
- Nenet 3, 21, 22, 24, 32, 47, 53, dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
- Nenet 6, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si dhe protokolli shtesë i kësaj Konvente nr. 12.
- PËRPARA:** KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Prishtinë, 30.11.2016

KËRKESË PËR RISHQYRTIM TË VENDIMIT

ANKUES: Kolegji Dardania, i themeluar në vitin 2004 si Institucion i Arsimit të Lartë, i licencuar nga MASHT – Certifikata Nr. 898/02-1 të datës 01.12.2004, dhe Vendimi Nr. 583/02-1 të datës 09.05.2007 dhe i riakredituar në nivel institucional prej pesë (5) viteve (01.tetor 2013 – 30 shtator 2018. Për këtë shih edhe Vendimet e AKA Nr. 493/13, datë 08.07.2013 dhe 551/14, datë 04.07.2014).

OBJEKTI: Kërkohet ndryshimi i vendimit Nr. 1249/16, datë 07.11.2016 të KSHC të AKA me objekt “Refuzimi i riakreditimit të specializimit Marrëdhënie me Publikun të programit Bachelor Shkenca Politike me Administrim Publik, të Kolegjit Dardania dhe miratimi i kërkesës për akreditim sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

BAZA LIGJORE: Nenet 1, 2, 3, 4, 8, 11, 12, 13, 14 dhe 15 të Ligjit Nr. 04/L-037 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës”.

Nenet 9, 10, 11, dhe 29 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së RSK Nr. 02/2013 “Mbi Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të, Lartë në Republikën e Kosovës”.

Nenet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 11, 12, 13, 14, 44, 46-48, 52, 53, 55, 88, 89, 92, 95, 124, 125, 126, 127, 128, 129, 130, dhe 131 të Ligjit Nr. 05/L-031 “Për Procedurën e Përgjithshme Administrative”.

Nenet 3, 21, 22, 24, 32, 47, 53, dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Nenet 6, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si dhe protokolli shtesë i kësaj Konvente nr. 12.

PËRPARA: KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

*I Nderuari Z. Kryetar,
Të Nderuar Zonja e Zotërinj Anëtarë,*

Kolegji Dardania, i licencuar si Institucion i Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka paraqitur kërkesën për riakreditimin e disa programeve të studimit, ku, midis tjerash, përfshihej edhe kërkesa për riakreditimin e programit të studimit Bachelor në Shkencat Politike me Administrim Publik, me specializimet: Administrim Publik; Studime Evropiane, dhe; Diplomaci.

Pas përfundimit të procesit të paraparë, jemi informuar që nuk janë riakredituar specializimet Marrëdhëniet me Publikun, si dhe ato Studime Evropiane dhe Diplomaci. Për këtë arsye ne përmes këtij shkrimi parashtrojmë kërkesën si në dy pikat në vijim.

1. Të hidhet poshtë vendimi për mos-riakreditimin e Specializimit Marrëdhënie me Publikun. Ky Specializim nuk ka aplikuar për riakreditim sepse ka qenë i akredituar deri në vitin 2017, ashtu siç figuron në ueb-faqen e AKA – Nr. rend. 551/14, i datës 04.07.2014.

Nuk e kuptojmë pse, si, dhe nga kush është marrë vendimi që ky program të mos riakreditohet. Si ka mundësi që të mos akreditohet një program që tashmë është i akredituar? Kërkojmë nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë ta përmirësojë këtë gabim.

2. Po ashtu, kërkojmë nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë që të nxjerrë një vendim për akreditimin e specializimeve Studime Evropiane, dhe Diplomaci, që janë akredituar nga grupi i ekspertëve paraprakë, të vitit 2013. Rekomandimet e këtyre ekspertëve paraprakë, të vitit 2013, janë plotësuar ashtu siç janë kërkuar nga ata. Ndërkaq, grupi i fundit i ekspertëve, i vitit 2016, ka parashtruar rekomandime të reja si kusht për riakreditim. Këto rekomandime të reja do të përmbushen në afat prej 1 viti akademik nga organi kompetent, Këshilli Mësimor Shkencor, ashtu siç janë përmbushur edhe rekomandimet e grupit paraprak të ekspertëve. Mirëpo, ndërprerja e studimeve në programin që tashmë ka qenë në rrjedhje e sipër, i dëmton edhe studentët, edhe Kolegjin, edhe stafin e tij.

Me nderime,

Prof. Dr. Gjyldane Mulla

Rektore

